

Selami Zalli, Drejtor i Drejtorisë të Kërkesave të Qytetarëve dhe Shërbimeve Rehabilituese, pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Në vitin 1984-1988, ka përfunduar studimet e larta në Fakultetin **Histori** - Gjeografi.

Në vitin 1993-1994, ka përfunduar studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë Universiteti i Tiranës (*kurs i përshpejtuar*), më parë në vitin 1992 kishte konkuruar dhe fituar të drejtën e studimit pa shkëputje nga puna në Fakultetin Juridik, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër ku dhe është diplomuar në vitin 1997 (*duke u ridiplomuar*) dhe fituar titullin **Jurist**.

Në vitin 2008 ka përfunduar studimet pasuniversitare (*magjistraturën*) duke fituar titullin (thirrjen akademike) **Magjistër i Shkencave Juridike - Penale**, nga Universiteti i Prishtinës, diplomë e njohur dhe ekuivalentuar si postmastër (*Master shkencor*) nga Ministria e Arsimit e Shqipërisë.

Në vitet 2010 - 2012 është angazhuar si **pedagog** i lëndës E Drejtë Publike dhe Civile pranë Fakultetit FASTIP, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës.

Në vitin 2014 ka fituar titullin **Avokat**, të cilin nuk e ka ushtruar për shkak të funksionit.

Ka eksperiencë në punë;

- mars 2017 e në vazhdim Drejtor i Drejtësisë së Informacionit, pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë
- korrik 2010 - mars 2017, Ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë,
- korrik 2010-prill 2009, Drejtor i Inspektimit për prokurorinë në Ministrinë e Drejtësisë,
- prill 2009-dhjetor 2005, Përgjegjës i sektorit të Inspektimit në Ministrinë e Drejtësisë,
- dhjetor 2005-mars 2004, prokuror, Prokuroria e Rrethit Fier,
- mars 2004-qershor 2001, prokuror, Prokuroria e Rrethit Pogradec,
- qershor 2001- korrik 1994, prokuror, Prokuroria e Përgjithshme,
- 1994-1993, hetues, Prokuroria e Rrethit Tiranë.
- 1988-1993, mësues i lëndës së Historisë.

Ka marrë pjesë në një numër të konsiderueshëm trajnimesh, brenda dhe jashtë vendit, një pjesë e të cilave, kanë përqsasje të plotë me kërkesat e ushtrimit të funksionit që mban. Ka shfaqur interes dhe marrë pjesë në aktivitete të zhvilluara në fushën e arkivave.